

SKEMA PËR VLERËSIM TË TESTIT NGA GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA PAS PËRFUNDIMIT TË KLASËS IX, QERSHOR 2015

DETYRA 1.

1 pikë – përgjigja e saktë: **Anketa ka të bëjë me përfshirjen më të madhe të filmit në mësimdhënie.**

0 pikë - të tjera (është shkruar ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

DETYRA 2.

1 pikë – përgjigja e saktë: **563 nxënës ose 68,84%**

Vërejtje: Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan qoftë numrin e nxënësve apo shifrën e përqindjes

0 pikë - të tjera (është shkruar ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

DETYRA 3.

1 pikë - është rrethuar përgjigja **3. nuk janë dakord me këtë**

0 pikë - të tjera (është rrethuar përgjigja 1, ose 2, janë rrethuar dy ose më shumë përgjigje, nuk është rrethuar asgjë)

DETYRA 4.

1 pikë - është rrethuar përgjigja **4. Njeriu gjen gjithmonë një mundësi**

0 pikë - të tjera (është rrethuar përgjigja 1, 2 ose 3, janë rrethuar dy ose më shumë përgjigje, nuk është rrethuar asgjë)

DETYRA 5.

1 pikë - nëse nxënësi/ja ka shkruar: **Fruta.**

0 pikë - të tjera (është shkruar ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

DETYRA 6.

5 pikë (nga 1 pikë për çdo përgjigje të saktë)

Nr.	Pjesa e zgjedhur	Është figurë letrare:
1	Të mëdhenj	<i>epitet</i>
2	Portokall-mundësi	<i>metaforë</i>
3	Portokalli dëshironte t'i bënte të lumtur	<i>personifikim</i>
4	Rritën si unë	<i>krahasim</i>
5	Mëmë - Pemë	<i>metaforë</i>

0 pikë - të tjera (është dhënë ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

DETYRA 7.

1 pikë - nëse nxënësi/ja ka shkruar: ***emër konkret***

0 pikë - të tjera (është shkruar ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

DETYRA 8.

1 pikë - është rrethuar përgjigjja **1. *Bindjen se bota mund të ndryshojë***

0 pikë - të tjera (është rrethuar përgjigjja 2, 3 ose 4, janë rrethuar dy, tri ose të katër përgjigjet, nuk është rrethuar asgjë)

DETYRA 9.

1 pikë - nëse nxënësi/ja ka shkruar: ***Dëshira për të parë botën***

0 pikë - të tjera (është shkruar ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

DETYRA 10.

1 pikë - është rrethuar përgjigjja **1. *Bashkërenditëse shtuese***

0 pikë - të tjera (është rrethuar përgjigjja 2, 3 ose 4, janë rrethuar dy, tri ose të katër përgjigjet, nuk është rrethuar asgjë)

DETYRA 11.

2 pikë - nëse nxënësi/ja ka rrethuar nën **A)** numrin **2. kalimtare**, ndërsa nën **B)** ka shkruar:

Portokalli i ëmbël.

1 pikë - nëse ka dhënë përgjigje të saktë ose nën **A)** ose nën **B)**

0 pikë - të tjera (është shkruar ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

DETYRA 12.

1 pikë - nëse nxënësi/ja ka shkruar: ***Djali që ishte më i fortë e mori portokallin***

0 pikë - të tjera (është shkruar ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

DETYRA 13.

2 pikë - nëse nxënësi/ja e ka zgjeruar grupin emëror të kryefjalës nën **A) *Miqtë e tu të dashur e të mirë*** dhe grupin foljor të kallëzuesit nën **B) *Qëndrojnë lartë në maje të pemës plot krenari.***

1 pikë - nëse nxënësi/ja ka shkruar saktë ose në **A)** ose nën **B)**

0 pikë - të tjera (është dhënë ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

DETYRA 14.

1 pikë - është rrethuar përgjigjja **1. *njeri***

0 pikë - të tjera (është rrethuar përgjigjja 2 ose 3, janë rrethuar dy ose të tri përgjigjet, nuk është rrethuar asgjë/nuk është dhënë ndonjë përgjigje)

DETYRA 15.

1 pikë - është rrethuar përgjigjja **1. Artian ma jep dorën!**

0 pikë - të tjera (është rrethuar përgjigjja 2 ose 3, janë rrethuar dy ose të tri përgjigjet, nuk është rrethuar asgjë)

DETYRA 16.

2 pikë - nëse nxënësi/ja i ka gjetur fjalisë së dhënë kryefjalën dhe ka treguar se me çka është shprehur ajo, përkatësisht ka shkruar rasën, numrin ose vetën: **Ai – është kryefjalë; që është përemër; në rasën emërore; në vetën e tretë; në numrin njëjës.**

1 pikë - nëse nxënësi/ja ka gjetur të paktën dy elemente të kërkuara

0 pikë - të tjera (janë gjetur saktë më pak se dy elemente të kërkuara është dhënë ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

DETYRA 17.

3 pikë (nga 1 pikë për çdo përgjigje të saktë)

Thnegël – **thnegla**

I sotëm – **i sotmi**

I cekët – **i cekëti**

0 pikë - të tjera (është dhënë ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

DETYRA 18.

3 pikë (nga 1 pikë për çdo përgjigje të saktë)

Robë-ri: **në rrokjen e fundit**

Va-tër: **në rrokjen e parë**

Pas-qyrë: **në rrokjen e dytë**

0 pikë - të tjera (është dhënë ndonjë përgjigje tjetër ndryshe nga ajo që është kërkuar, nuk është dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

DETYRA 19.

4 pikë – Nëse nxënësi/ja e plotëson saktë vërtetimin me të dhënat që i janë ofruar dhe i respekton rregullat drejtshkimore (shkrimin e saktë të shkronjës së madhe dhe të vogël, shkrimin e saktë të numrave, shenjave të pikësimit etj.)

3 pikë – Nëse nxënësi/ja e plotëson saktë vërtetimin dhe ka një gabim drejtshkrimor

2 pikë – Nëse nxënësi/ja e plotëson saktë vërtetimin dhe ka dy gabime drejtshkrimore

1 pikë – Nëse nxënësi/ja e plotëson saktë vërtetimin dhe ka tri gabime drejtshkrimore

0 pikë - të tjera (nëse nxënësi/ja e plotëson saktë vërtetimin dhe ka katër e më shumë gabime drejtshkrimore ose nuk e plotëson saktë vërtetimin, nuk ka dhënë asnjë lloj përgjigjeje)

20.

1. Skema për vlerësimin e hartimit me temën: **PROFESIONI IM I PREFERUAR**

Përmbajtja – 10 pikë

Kërkesa 1.

Nxënësi/ja:

merr 1 pikë për përshkrimin më të thjeshtë të mendimit të tij/të saj personal për profesionin, rëndësinë dhe rolin e tij në përgjithësi; Nëse jep një përshkrim më të plotë dhe më me stil të mendimit të tij/të saj personal për profesionin, rëndësinë dhe rolin e tij në përgjithësi , merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 2.

Nxënësi/ja:

merr 1 pikë për përshkrimin më të thjeshtë të profesionit të preferuar, ku bën pjesë ai, ku bën pjesë ai, sa është kreativ; Nëse jep një përshkrim më të plotë dhe më me stil të profesionit të preferuar, ku bën pjesë ai, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 3.

Nxënësi/ja:

merr 1 pikë për përshkrimin më të thjeshtë të punës me të cilën merret profesioni i tij/i saj i preferuar; Nëse jep një përshkrim më të plotë dhe më me stil të punës me të cilën merret profesioni i tij/i saj i preferuar, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 4.

Nxënësi/ja:

merr 1 pikë për përshkrimin më të thjeshtë të simpativë që ka ndaj profesionit të tij/të saj të preferuar; Nëse jep një përshkrim më të plotë dhe më me stil të simpativë që ka ndaj profesionit të tij/të saj të preferuar, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 5.

Nxënësi/ja:

merr 1 pikë për dhënie më të thjeshtë të disa mendimeve apo vlerësimeve për profesionin që pëlqen ai/ajo, çfarë e bën atë të veçantë; Nëse jep disa mendime apo vlerësime më të plota dhe më me stil për profesionin që pëlqen ai/ajo, çfarë e bën atë të veçantë, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Gjuha dhe struktura e tekstit – 8 pikë

Leksiku	Gramatika dhe drejtshkrimi	Lidhshmëria	Struktura e tekstit
<p>→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, zgjedhja përkatëse e fjalëve, përdorimi i figurave stilistike</p> <p>2 pikë</p>	<p>→ respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, formave gramatikore, kongruencës; rrumbullakimi kuptimor i fjalisë, renditja e saktë e fjalëve në fjali)</p> <p>2 pikë</p> <p>→ respektimi i normës drejtshkimore (përdorimi i drejtë i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe i shenjave themelore të pikësimit, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)</p> <p>2 pikë</p> <p>Gjithsej 4 pikë</p>	<p>→ renditja e natyrshme e të dhënave të ofruara, lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit dhe pjesëve të tij</p> <p>1 pikë</p>	<p>→ përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe formës së tekstit strukturës së tij logjike (e ndan hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin)</p> <p>1 pikë</p>

Leksiku	Gramatika dhe drejtshkrimi	Lidhshmëria	Struktura e tekstit
<p>→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, zgjedhja përkatëse e fjalëve, por pa përdorimin e figurave stilistike</p> <p>1 pikë</p>	<p>→ respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet semantike...)</p> <p>1 pikë</p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të vogla (gabimet e vogla në shenjat e pikësimit: presja te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)</p> <p>1 pikë</p> <p>Gjithsej 2 pikë</p>		